

L I G J
Nr.7516, datë 7.10.1991

PËR SINDIKATAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491 datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

Neni 1

Sindikatat në Republikën e Shqipërisë janë organizata shoqërore që krjohen si bashkime vullnetare të punonjësve për mbrojtjen e të drejtave e të interesave të tyre ekonomike, profesionale e sociale.

Organizimi dhe veprimtaria e sindikatave është e lirë dhe e garantuar me ligj.

Neni 2

Sindikatat mund të organizohen sipas degëve, profesionit ose mbi bazë territori në sektorin shtetëror a privat.

Neni 3

Në sindikata kanë të drejtë të hyjnë të gjithë punonjësit, pavarësisht nga bindjet e tyre politike, ideologjike e fetare. Të drejtën për të hyrë në sindikata e kanë edhe personat që kanë dalë në pension, ose që jetojnë me përkrahje sociale.

E drejta për t'u bërë anëtar i sindikatës përcaktohet në statutin e sindikatës.

Neni 4

Sindikatat krijohen me kërkesat e mbi 200 punonjësve dhe me miratimin e Ministrisë së Drejtësisë.

Punonjësit që kërkojnë të formojnë sindikatë, i drejtojnë kërkesën e tyre Ministrisë së Drejtësisë, duke i paraqitur edhe dokumentet përkatëse (statuti dhe programi i sindikatës).

Në kërkesën për njohjen e sindikatës duhet të shënohet:

- a) Emri dhe qendra e sindikatës,
- b) Qëllimet dhe detyrat e saj;
- c) Burimet financiare;
- d) Territori ku ajo e ushtron veprimtarinë.

Neni 5

Organizimi dhe struktura e sindikatës përcaktohet nga statuti i sindikatës. Në statut përcaktohen gjithashtu kriteret e pranimit në sindikatë, të drejtat dhe detyrat e anëtarëve, organet drejtuese të sindikatës dhe mënyra e zgjedhjes së tyre, kompetencat e organeve drejtuese, burimet financiare, koutat e anëtarësisë, territori ku vepron dhe emri i sindikatës.

Neni 6

Ministria e Drejtësisë duhet të shpallë miratimin ose refuzimin e kërkesës për krijimin e sindikatës brenda 30 ditëve nga data e marrjes në dorëzim të saj.

Kur Ministria e Drejtësisë vëren se dokumentet nuk janë të plota, ose nuk janë zbatuar rregullat e caktuara në këtë ligj brenda 20 ditëve e kthen kërkesën për plotësimet përkatëse.

Kundër urdhërit të Ministrit të Drejtësisë që refuzon kërkesën për krijimin e një sindikate, mund të bëhet ankim brenda 15 ditëve nga dita e marrjes dijeni në Gjykatën e Lartë, e cila është detyruar që brenda 30 ditëve të shqyrtojë çështjen. Vendimi i Gjykatës së Lartë është i formës së prerë.

Neni 7

Sindikatat janë organizata shoqërore të pavarura nga punëdhënësi, administratat shtetërore dhe partitë politike.

Në veprimtarinë e tyre ato udhëhiqen vetëm nga vullneti i lirë i anëtarëve, duke u mbështetur në Kushtetutën, ligjet, statutin dhe programin e tyre.

Sindikatat janë të detyruara të respektojnë rendin juridik. Ato nuk merren me veprimtari të mirëfilltë politike.

Neni 8

Sindikatat, me veprimtarinë që kryejnë, mbrojnë të drejtat dhe interesat e anëtarëve të tyre që lidhen me pagat, kushtet e punës, të banimit e të pushimit, si dhe nevojat socialkulturore, duke përdorur vetëm metoda e mjete demokratike të njohura me ligj, siç janë mbledhje mitingjet, manifestimet dhe grevat.

Neni 9

Sindikatat kanë të drejtë të mbrojnë edhe interesat ekonomike të punonjësve që kanë dalë në pension, ose që jetojnë me përkrahje sociale.

Neni 10

Anëtarësia në sindikatë dhe aktivizimi në veprimtarinë sindikaliste, nuk sjell asnjë kufizim të drejtave të punonjësit dhe nuk mund të shërbejë si shkak që punëdhënësit ta largojë atë nga puna.

Neni 11

Për të garantuar të zgjedhurit në organet drejtuese sindikaliste në kryerjen e detyrës së tyre, punëdhënësit i ndalohej t'i largojë a transferojë ata nga puna, pa marrë më parë pëlqimin e organizatës sindikaliste përkatëse, përveç rasteve kur vërehen shkelje të legjislacionit dhe të kontratës kolektive të punës.

Neni 12

Aktivistët sindikalistë për kryerjen e veprimtarisë së tyre, si dhe për të marrë pjesë në aktivitet sindikaliste me karakter lokal, kombëtar e ndërkombëtar, mund të shkëputen nga puna dhe të paguhen nga punëdhënësi, në qoftë se palët bien dakord.

Kontrata kolektive e punës midis palëve, përcakton kohën dhe mënyrën e pagesës.

Neni 13

Të zgjedhurit në forumet sindikaliste si funksionarë, kanë të drejtë të rikthehen në vendin e tyre të punës me mbarimin ose heqjen e mandatit.

Anëtarët e organeve drejtuese të sindikalistëve lejohen të kryejnë veprimtari sindikale në ndërmarrje, institucione duke qënë të pajisur me dokumentin përkatës të sindikatës.

Neni 14

Sindikatat janë persona juridikë. Ato kanë pasuri dhe ushtrojnë aktivitet ekonomik për kryerjen e veprimtarisë së tyre në përshtatje me qëllim për të cilin janë krijuar.

Neni 15

Burimet materiale e financiare të sindikatës përbëhen nga:

- a) kuotat e anëtarësisë;
 - b) çdo pasuri tjetër e fituar në mënyrë të ligjshme;
 - c) të ardhurat nga veprimtaria ekonomike e socialkuturore.
- Të ardhurat që sindikatat fitojnë nga kuotat e anëtarësisë nuk tatohen.

Neni 16

Sindikatat kanë të drejtë të kenë shtypin e tyre, si dhe të pasqyrojnë veprimtarinë e tyre në mjetet shtetërore të informacionit masiv.

Neni 17

Kontrata kolektive e punës që lidhet ndërmjet organeve drejtuese të sindikatës dhe punëdhënësit ëdhtë e detyrueshme.

Mënyra e lidhjes së kontratës kolektive të punës, të drejtat dhe detyrat e palëve, si dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve në mes tyre përcaktohen me ligj.

Kontrata kolektive e punës nuk mund t'i cënojë të drejtat dhe garancitë që punonjësve u njihen nga legjislacioni i punës dhe ai civil.

Neni 18

Organet drejtuese të sindikatave kanë të drejta të mbajnë lidhje e të zhvillojnë bisedime me organet shtetërore dhe ekonomike, të cilat nga ana e tyre janë të detyrueshme t'u venë në dispozicion pa pagesë të dhënat e statistikës ekonomike e financiare.

Neni 19

Përfaqësuesit e organeve qendrore të sindikatave kanë të drejtë të hyjnë në bisedime me Këshillin e Ministrave dhe me ministritë e institucionet e tjera qendrore për probleme që lidhen me marrëdhëniet e punës, pagat, kushtet e punës dhe të jetesës së punonjësve, ose me pensionet dhe përkrahje sociale.

Neni 20

Sindikatat kanë të drejtë të mbajnë lidhje e të bashkëpunojnë me organizatat dhe lëvizjet sindikaliste të vendeve të tjera dhe të bëhen anëtarë të organizatave dhe lëvizjeve sindikaliste ndërkombëtare.

Neni 21

Nuk lejohet krijimi i një sindikate, ose ndalohet veprimtaria e saj, kur qëllimet i propagandon dhe përpiqet t'i realizojë me përdorimin e dhunës, forcën e armëve dhe me çdo mjet tjetër antidemokratikë, si dhe kur veprimtaria e saj është në kundërshtim me dispozitat kushtetuese me këtë ligj, dhe me statutin ose programin e miratuar.

Neni 22

Ministri i Drejtësisë urdhëron çregjistrimin e sindikatës kur:

- a) konstaton sheljet e parashikuara në nenin 21 të këtij ligji;
- b) numri i anëtarëve të sindikatës ulet nën 200 veta,
- c) personat juridikë, ku ushtron veprimtarinë sindikale mbyllen.

Neni 23

Gjykata e rrethit kur vërteton se punëdhënësi nuk respekton kontratën kolektive të punës, pengon sindikatën në kryerjen e veprimtarisë së saj, diskriminon aktivistët, sindikalistët ose shkel detyrimet që rrjedhin nga ky ligj, me kërkesën e prokurorit a të organit drejtues të sindikatës dënon personat përgjegjës me gjobë deri në 5000 lekë. Ajo urdhëron rivendosjen e së drejtës së shkelur e shpërblimin e dëmit të shkaktuar.

Kundër vendimit të gjykatës së rrethit mund të bëhet ankim në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë, sipas rregullave të Kodit të Procedurës Civile.

Neni 24

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.61 datë 12.10.1991 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Ramiz Alia